

VENDIM
Nr.489, datë 20.7.2011

PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME PUNONJËS TË POLICISË SË SHTETIT, NË MISIONIN E FORCAVE TË NDIHMËS PËR SIGURINË NDËRKOMBËTARE (ISAF), NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 438, datë 28.6.2011 “Për pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit Shqiptar në misione policore paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit” dhe të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një grupi ekspertësh nga Policia e Shtetit, në kuadër të kontributit të NATO-s, në Afganistan (ISAF), si pjesë përbërëse e misionit trajnues të NATO-s në Afganistan (NTN-A).

2. Grupi i ekspertëve të Policisë së Shtetit, që do të dërgohet në këtë mision, përbëhet nga 5 (pesë) punonjës policie.

3. Misioni dhe detyrat e punonjësve të Policisë së Shtetit është të trajnojnë dhe të këshillojnë punonjësit e Policisë Afgane në Komandën Rajonale Qendrore (RC-C), pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Policisë, Kabul-Afganistan, me qëllim zhvillimin e një force policore afgane më profesionale.

4. Transporti strategjik është përgjegjësi e palës shqiptare dhe amerikane, e cila rregullohet nga dokumenti “Udhëzimi për sigurimin e transportit dhe mbështetjes për forcat e Aleancës në Irak dhe Afganistan” (Guidance for Providing Lift and Sustain Support to Coalition and Friendly Foreign in Iraq and Afghanistan).

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është 3 (tre) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të grupit të parë në Afganistan, me rotacion çdo 6 (gjashtë) muaj.

6. Ministria e Brendshme të përballojë, për pjesëmarrësit në këtë mision, shpenzimet për:

a) shpërblimin që do të marrin punonjësit e policisë për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) shërbimet telefonike postare;

ç) transportimin e punonjësit të policisë për në atdhe, në raste vdekjesh, sëmundjesh dhe thyerjesh disiplinore;

d) veprimtaritë social-kulturore dhe festat kombëtare;

dh) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e operacionit.

7. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me INSIG sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet të punonjësve të policisë të Republikës së Shqipërisë që do të marrin pjesë në këtë mision, për shumën e përgjithshme të përfitimit nga siguri i jetës, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për çdo punonjës policie.

8. Efektet financiare, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen si më poshtë vijon:

- 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave;

- 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë nga buxheti i Ministrisë së Brendshme, programi “Policia e Shtetit”.

Për vitet në vazhdim, efektet financiare të përballohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

9. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha